



BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Prill 2024

BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Prill 2024

AKTIVITETET E KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

(Në edicionin e Buletinit të KPK-së pasqyrohen
aktivitetet për muajin prill të vitit 2024)

Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KPK-
së takon administratorët e prokurorive të
vendit

Prishtinë, 3 prill 2024

Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit
Prokurorial të Kosovës (SKPK), Sami Istrefi,



ka diskutuar me administratorët e prokurorive të
vendit për avancimin e efikasitetit, efektivitetit,
integritetit dhe ngritjen e kapaciteteve të nevojshme
për administrimin e prokurorive, që ndikojnë në
fuqizimin e mëtejshëm të proceseve të punës në
administratën e sistemit prokurorial.



Drejtori Istrefi vlerësoi angazhimin e shtuar të
administratorëve në proceset e tashme të punës dhe
njofto se kohëve të fundit ka vizituar të gjitha
prokuroritë, ku ka marrë informacione për vështirësitë
dhe sfidat e tyre, në mënyrë që të ketë një pasqyrë sa

më të qartë për të ofruar mbështetje për të gjitha prokuroritë dhe për të krijuar kushte sa më të mira të punës për to.

Diskutohet për draftet e katër rregulloreve për administratën e sistemit prokurorial

Prishtinë, 4 prill 2024

Komisioni për Çështje Normative ka diskutuar, trajtuar dhe analizuar katër akteve nënligjore, të hartuara nga grupet punuese, të cilat kanë të bëjnë me



regullimin e procedurave të ndryshme rekrutuese, klasifikuese, planifikuese dhe disiplinore për stafin administrativ të sistemit prokurorial.



Në takimin e sotëm është theksuar se bazuar në rëndësinë që ka administrata për mirëfunksionimin e sistemit prokurorial janë përgatitur edhe analizat përkatëse ligjore për të mbështetur punën e grupeve punuese për hartimin e këtyre draftrregulloreve.

Drafti i Rregullores për Procedurat e Rekrutimit për Pranim në Sistemin Prokurorial, drafti i Rregullores për Klasifikimin e Vendeve të Punës, drafti i Rregullores për Planifikimin e Personelit dhe drafti i Rregullores për Krijimin dhe Përbërjen e Komisionit Disiplinor do të publikohen në faqen zyrtare për dëgjim publik për marrrjen e opinioneve përkatëse dhe pas finalizimit do të procedohen për miratim në takimet e radhës së Këshillit Prokurorial.

Kryesuesi Hajdaraj viziton Prokurorinë Themelore në Mitrovicë

Prishtinë, 5 prill 2024

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Ardian Hajdaraj, vizitoi Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, i shoqëruar nga Drejtori i Përgjithshëm i SKPK-së, Sami Istrefi, ku është pritur nga Kryeprokurori i kësaj prokurorie, Ismet Ujkani.



Kryeprokurori njoftoi Kryesuesin për mbarëvajtjen e punëve dhe për sfidave aktuale në hetimin dhe ndjekjen e veprave penale në territorin që ka në kompetencë kjo prokurori, si dhe vështirësitë me të cilat ballafaqohet, duke theksuar se pas dorëheqjes së prokurorëve dhe stafit administrativ ka pasur sfida për trajtimin e lëndëve të natyrës urgjente.



Më tej u diskutua për gjetjen e modaliteteve për vazhdimin dhe menaxhimin e nevojshëm tëpunës, si dhe për nevojat konkrete të kësaj prokurorie, me qëllim zbatimin e mandatit të saj kushtetues dhe ligjor, me ç'rast Kryesuesi Hajdaraj do të ofrojë mbështetje në bazë të kompetencave të tij, me ç'rast është zotuar se do të ndërmarrë të gjitha masat për krijimin e kushteve sa më të favorshme të punës, të cilat do të ndihmonin avancimin e sundimit të ligjit në këtë pjesë të vendit.

Plotësimi i kushteve të punës, rritja e efikasitetit, zbatimi i parimit të meritokracisë

dhe forcimi i integritetit të administratës së sistemit prokurorial, prioritete të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të KPK-së

Prishtinë, 8 prill 2024

Në kuadër të iniciativës për të vizituar të gjitha prokuroritë e vendit, Drejtori i Përgjithshëm i SKPK-së, z.Sami Istrefi, zhvilloi takime me administratorë, bashkëpunëtorë profesionalë, zyrtarë ligjorë, mbrojtës të viktimave dhe zyrtarë të tjerë të administratës së sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës.



Gjatë takimeve të zhvilluara në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, Prokurorinë e Apelit, Prokurorinë Speciale, prokuroritë themelore dhe Zyrën për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave, Drejtori Istrefi është njohur për së afërmi me gjendjen, nevojat dhe sfidat e administratës në të gjitha nivelet, me ç'rast të gjithë zyrtarët e pranishëm patën rastin që t'i adresojnë çështjet me të cilat përballën gjatë punës së tyre të përditshme.



Z.Sami Istrefi, duke vlerësuar angazhimin, kontributin dhe punën e punonjësve administrativë të sistemit prokurorial, ka shprehur gatishmërinë e tij që brenda kompetencave dhe mundësive të tij ligjore të angazhohet maksimalisht për plotësimin e kushteve dhe nevojave të tyre, në mënyrë që t'i mundësojë institucionit të Prokurorit të Shtetit të realizojnë mandatin e tyre me efikasitet dhe profesionalizëm të madh.

Gjithashtu, në këto takime, z.Istrefi prezantoi vizionet dhe prioritetet e tij, që kanë të bëjnë me ndërtimin e një qasjeje të re dhe proaktive nëpërmjet fuqizimit të komunikimit të brendshëm institucional, si formë dhe mekanizëm i tejkalimit të sfidave të përbashkëta, rritjen e dinamikës së punës dhe efikasitetit të shërbimeve që ofron administrata, avancimin e njohurive nëpërmjet trajnimeve profesionale, forcimin e integritetit, llogaridhënien dhe transparencën, si dhe zbatimin e parimit të meritokracisë, objektivitetit dhe profesionalizmit gjatë proceseve të vlerësimit, ngritjes në detyrë dhe rekrutimit të stafit, të cilat do të zhvillohen në të ardhmen brenda sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës.

Në vijim janë pamjet nga takimet e zhvilluara nëpër të gjitha prokuroritë e vendit:







Prishtinë, 10 prill 2024

Në urimin e Kryesuesit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, z.Ardian Hajdaraj, me rastin e festës së Fitër Bajramit, thuhet:

Të nderuar besimtarë të fesë islame,

Me rastin e festës së Fitër Bajramit uroj që kjo festë e bekuar t'ju sjellë harmoni, solidaritet, begati dhe mirëqenie në familjet tuaja!



Fitër Bajrami le të jetë motivim i madh për humanitet dhe le të shërbejë për respektimin e dinjitetit dhe vlerave të përgjithshme njerëzore!

Me fat Fitër Bajrami!



Mbahet Takimi i 246-të i Këshillit Prokurorial

Prishtinë, 11 prill 2024

Këshilli i Prokurorial i Kosovës, i udhëhequr nga Kryesuesi Ardian Hajdaraj, ka mbajtur Takimin e 246-të të me radhë, në të cilin u trajtuan pikat që



ishin në rendin e ditës.

Urimi i Kryesuesit Hajdaraj me rastin e festës së Fitër Bajramit

Anëtarët e Këshillit aprovuan njëzëri propozimin për përgatitjen e përmbledhjes së shkurtuar të procesverbaleve të takimeve të KPK-së, ngaqë, faktikisht, takimet e KPK-së transmetohen çdoherë online dhe fjalimet e plota të secilit anëtarë mund të ruhen dhe gjenden lehtë.



Në vijim të takimit është diskutuar edhe lidhur me vështirësitë e krijuara gjatë trajtimit të lëndëve në Prokurorinë Themelore të Mitrovicës pas dorëheqjes së prokurorëve të komunitetit serb, ku është paraqitur nevoja e plotësimit me prokurorë shtesë, me ç'rast është aprovuar rekomandimi i Kryesuesit të KPK-së për gjetjen e një zgjidhjeje të përkohshme me anë të transferimit të tre (3) prokurorëve për një periudhë tremujore, çështje kjo, e cila se do të trajtohet në kolegijumin e radhës së kryeprokurorëve prokurorive të vendit, pastaj do të informohet KPK-ja për të marrë vendim lidhur me këtë çështje.

Qasja proaktive në fushën e komunikimit publik, temë e diskutimit të Drejtorit të Përgjithshëm me zyrtarët për komunikim në sistemin prokurorial

Prishtinë, 17 prill 2024

Një takim pune me zyrtarët e shërbimit të komunikimit publik në sistemin prokurorial ishte takimi i radhës i Drejtorit të Përgjithshëm të SKPK-së, z.Sami Istrefi, në të cilin është diskutuar për zbatimin



e konkluzioneve të takimit paraprak, të cilat kanë të bëjnë me avancimin e mëtejshëm të komunikimit

publik nëpër prokuroritë e vendit, duke i dhënë një rol prioritar ofrimit të shërbimeve cilësore dhe efikase për publikun e gjerë nga ana e Këshillit Prokurorial, Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit dhe prokurorive të vendit.

Z.Istrefi konfirmoi angazhimin e tij për krijimin e kushteve sa më të mira të punës për zyrtarët e shërbimit të komunikimit publik në sistemin prokurorial, në mënyrë që të kryhen me sukses detyrat dhe objektivat e përcaktuar në procesin e përditshëm të punës së zyrtarëve për komunikim publik. “Qëllimi, synimi dhe angazhimi ynë i përbashkët është që të arrijmë qasje sa më proaktive në fushën e komunikimit me publik”, ka thënë z.Istrefi në takimin e sotëm.

U raportua edhe për zhvillimin, dizajnimin dhe lansimin e uebportalit të ri, me ç'rast u tha se ky portal i financuar nga UNDP-ja do të ofrojë një qasje shumë më të lehtë në informacionet dhe dokumentet publike të sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës.

Kryesuesi dhe Zëvendëskryesuesja e Këshillit Prokurorial vizitojnë institucionet e drejtësisë amerikane

Prishtinë, 19 prill 2024

Në kuadër të vizitës pesëditore në institucionet e drejtësisë së SHBA-së, Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, z.Ardian Hajdaraj dhe Zëvendëskryesuesja e KPK-së, znj.Jehona Grantolli, së bashku me U.D.Kryeprokurorin e Shtetit, z.Besim Kelmendi, Kryetarin e Gjykatës Supreme të Kosovës, z.Fejzullah Rexhepi, Prokurorin në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, z.Aleksandër Lumezi, Kryetarin e Komisionit të Vlerësimit të Performacës në KPK, z.Veton Shabani dhe Drejtorin e Akademisë së Drejtësisë, z.Enver Fejzullahu, të shoqëruar nga Këshilltari Rezident Ligjor në OPDAT, z.John Hanley dhe Zyrtarja e Lartë Ligjore



në OPDAT, znj.Benina Kusari, janë pritur në takim nga Kryeprokurori i Përgjithshëm i Karolinës së

Jugut, z.Alan Wilson dhe Kryetari i Gjykatës Supreme të Karolinës Jugore, z.Donald W. Beatty.



Delegacioni i lartë kosovar, në takimin e zhvilluar në Zyrën e Kryeprokurorit të Përgjithshëm të Karolinës së Jugut, është informuar për perspektivën dhe përvojat e Zyrës së Kryeprokurorit të Përgjithshëm për hartimin e opinioneve nga Kryeprokurori i Përgjithshëm, rolin i Divizionit Ekzekutiv të Kryeprokurorit të Përgjithshëm në raport me çështje të bashkëpunimit me Qeverinë Amerikane dhe proaktiviteti i Zyrës për Marrëdhënie me Publikun dhe trajtimin e kërkesave për informacion nga mediat dhe publiku dhe aspekte të tjera profesionale, si dhe për proceset, veprimtarinë e përgjithshme dhe aktiviteteve konkrete gjyqësore të Gjykatës Supreme të Karolinës Jugore.



Në një sesion, të zhvilluar nga kjo vizitë pesëditore e delegacionit të përfaqësuesve të sistemit të drejtësisë së Kosovës në SHBA, ishte edhe njohja nga afër me operimin e Qendrës së Trajnimeve dhe edukimin ligjor, si dhe për teknikat dhe metodat e vlerësimit të prokurorëve nga përfaqësuesit e Zyrës për Menaxhimin e Sektorit të Drejtësisë nga Uashingtoni dhe prezantim i Ndhimësdrejtorit për Çështje të Sigurisë Nacionale dhe Kriminalistikë, z.Douglas Squires, me ç'rast në fokus ishte procesi i vlerësimit dhe i rishikimit të prokurorive (EARS) dhe praktikat menaxheriale për vlerësimin e performancës së prokurorëve, transparencën dhe llogaridhënia e prokurorisë.

Gjatë vizitës në Fakultetin Juridik të Karolinës së Jugut, delegacioni pati nderin të takohej me fituesin e Çmimit Nobel për Paqe, z.David Beasley, i cili ka marrë pjesë në misionin paqeruajtës në Kosovë dhe në misione të tjera paqeruajtëse në botë. Po ashtu, ky delegacion zhvilloi edhe një takim në Gjykatën e Qarkut në Charlstone, ku kanë marrë pjesë në dy seanca për matjen e dënimit.

Vizita e delegacionit nga Kosova në institucionet e drejtësisë amerikane është organizuar nga Ambasada e SHBA-së në Kosovë dhe Zyra e OPDAT-it.

Mbahet takimi i Komisionit për Rishqyrtim të ankesave të aplikuesve në fazën preliminare për prokurorë të rinj të shtetit

Prishtinë, 22 prill 2024

Komisioni për Rishqyrtim të ankesave të aplikuesve për prokurorë të rinj të shtetit, i kryesuar nga anëtari i Këshillit Prokurorial të Kosovës, z.Arian Gashi, në përbërje të të cilit janë edhe Prokurori në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, z.Bahri Hyseni dhe anëtari rezervë, Prokurori në Prokurorinë e Apelit, z.Arben Ismajli, ka mbajtur një takim për t'i trajtuar ankesat e aplikuesve ndaj rezultatit të përzgjedhjes preliminare nga Komisioni për Rekrutim.



Këshilli Prokurorial i Kosovës do të njoftojë me kohë për procedurat e tjera të procesit të përzgjedhjes së prokurorëve të rinj në sistemin prokurorial.

Kryesuesi i KPK-së priti në takim njoftues shafen e Zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë

Prishtinë, 23 prill 2024

Kryesuesi Ardian Hajdaraj priti në një takim njoftues shafen e Zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë, Mary Ann Hennessey dhe Zëvendëshefin Tankut Soykan, duke e uruar të parën për detyrën e re, si dhe duke shprehur falënderimin e tij për përkrahjen

e ofruar nga ana e Zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë, si dhe informoi atë për aktivitetet, prioritetet dhe sfidat e Këshillit Prokurorial gjatë vitit 2024.



Z. Hajdaraj dhe znj. Ann Hennessey diskutuan edhe për funksionalitetin e Sistemit Informativ për Menaxhimin e Lëndëve (SMIL) dhe për dhunën në familje, veçanërisht për dhunën ndaj grave dhe angazhimin konkret për parandalimin e saj, duke dënuar fuqishëm vrasjet e grave që kanë ndodhur kohëve të fundit në vendin tonë.

Shefja e Zyrës së KE-së falënderoi kryesuesin e KPK-së për pritjen, duke e njoftuar për lansimin e një programi të veçantë për trajtimin e të akuzuarve që kanë bërë dhunë ndaj grave dhe për të parandaluar recidivizmin e tyre, duke rritur efikasitetin e luftimit të rasteve të dhunës ndaj grave në Kosovë.

Bashkëbiseduesit u shprehën të gatshëm për të vazhduar bashkëpunimin e mëtejshëm ndërmjet Këshillit Prokurorial dhe Zyrës së Këshillit Evropian në Prishtinë, me qëllim të rritjes së efikasitetit, llogaridhënies dhe transparencës publike të sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës.

Mbledhja, analizimi dhe përdorimi i statistikave për punën e prokurorive, temë e punëtorisë së organizuar nga KPK-ja me ekspertët ndërkombëtarë

29 prill 2024

Komisioni për Administrimin e Prokurorive i KPK-së, i kryesuar nga z. Jetish Maloku, organizoi punëtori dyditore, të mbështetur nga Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë, në të cilën morën pjesë anëtarët e Këshillit Prokurorial të Kosovës, prokurorë të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, kryeprokurorë dhe prokurorë të prokurorive të vendit, Grupi punues i SMIL-it, përfaqësuesi i Zyrës së BE-së në Kosovë, z. Mats Persson dhe zyrtarë të Sekretariatit të KPK-së

dhe Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorive, kurse përmes pjesëmarrjes online referojnë ekspertët dhe koordinatorët e KOSEJ-it në Sekretariatit e CEPEJ-it, konkretisht përfaqësuesi i Njësisë për Mbështetje në Prokurorinë Publike, z. Vitor Mendonça dhe Prokurori i Lartë Publik nga Portugalia, z. Jose Manuel Santos Pais.



Në sesionet e zhvilluara pati diskutime për zëvendësimin e statistikave manuale me statistika të gjeneruara automatikisht nga Sistemi Informativ i Lëndëve (SMIL), në përputhje me metodologjinë e CEPEJ-it, me ç'rast, kryesuesi i Komisionit për Administrimin e Prokurorive theksoi rëndësinë e trajtimit të praktikave të mira të sistemeve evropiane për cilësinë e të dhënave dhe statistikave dhe për kushtet e nevojshme për të garantuar cilësinë e statistikave të prokurorive të vendit, në përputhje me metodologjinë CEPEJ.



Në këtë punëtori janë diskutuar edhe procedurat e mbledhjes së statistikave dhe cilësia e futjes së të dhënave, ku janë prezantuar online rekomandimet e raportit të ekspertëve nga ekspertja e CEPEJ-it, znj. Ellen Van Dael dhe janë prezantuar raportet manuale statistikore që janë aktualisht në përdorim, si dhe është zhvilluar një diskutim me Grupin Punues të Përdoruesve të SMIL-it për raportet statistikore të disponueshme në SMIL dhe Planin e veprimit për muajt e ardhshëm për zëvendësimin e statistikave manuale me statistika të gjeneruara automatikisht nga SMIL.

Sipas pjesëmarrësve të kësaj punëtorie, objektivi kryesor i tyre është përmirësimi i mbledhjes, analizimit dhe i përdorimit të statistikave për të avancuar cilësinë dhe efikasitetin e prokurorive dhe mbështetja e KPK-së në zëvendësimin e statistikave manuale me statistika të gjeneruara automatikisht nga SMIL-i, si dhe adresimi i numrit të madh të lëndëve të pazgjidhura.

Në sesionet e ditës së dytë janë prezantuar rastet e pazgjidhura kundër autorëve të panjohur në vendet evropiane dhe gjendja aktuale me lëndët e pazgjidhura në Kosovë, si dhe u zhvilluan diskutime për trajtimin adekuat të numrit të madh të lëndëve të pazgjidhura në prokuroritë e Kosovës.